REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dep. Dep. Dep. 2-D/DPK
Nr. Prot Br.Prot Prot No 01-3009/14
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02
Data Datum Date 28-08-2014
PRISHTINË

# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.08.2014, mori:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti** me nr. AKK–03-2162/14, për **z. Labinot Shahini**, **Anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan** për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

**II.** Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Labinot Shahini, Anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së parapare në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z Shahini është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, për të cilin është dyshuar se ushtron dy funksione të papajtueshme, si Anëtar i Kuvendit Komunal në Lipjan dhe si person i autorizuar në biznesin privat Ambulanca Histopatologjike Citologjike "Patohistologjis-S".

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë. Me këtë rast ai është bindur me fakte për situatën në të cilën ndodhet si dhe ndryshimet të cilat duhet ti bëj, për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Shahini ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve po zgjatë Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet "njoftimi paralajmërues", me të cilin zyrtarit të lartë i është bërë e qartë se duhet të shmanget situata e konfliktit të interesit brenda afatit të caktuar, përndryshe do të pasojnë masat tjera sanksionuese të parapara me ligj

Ndërkohë, zyrtari i lartë z. Shahini ka dërguar në Agjenci shkresen zyrtare të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 2964/14) në të cilën vërtetohet se ka heq dorë nga funksioni menagjues në biznes privat.

**II.** Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)